



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

KOMISIONI I PAVARUR
I KUALIFIKIMIT
Nr. 2715 Prot.
Datë 23.03.2018

NR. 8 VENDIMI

Tiranë, më 23.03.2018

VENDIM

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Anëtar
Xhensila Pine	Relator

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj. Ina Serjanaj;
pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, në datën
23.03.2018, ora 15:00, në sallën nr. 1 të selisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në
shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Z. Ilir Pashaj - Gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

BAZA LIGJORE : Neni 179/b, pika 4, e Kushtetutës së Shqipërisë, nenet 14, 56 e 57, të ligjit
nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në
Republikën e Shqipërisë”.

Arsyet për pushimin e procesit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, Ilir Pashaj, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së
Parë Elbasan. Ky subjekt ka dhënë dorëheqjen nga detyra që ushtronte, duke e paraqitur këtë
dorëheqje, me shkrim, pranë Institucionit të Presidentit të Republikës.

Kjo dorëheqje është protokolluar pranë këtij Institucioni me nr.196.prot., datë 01.02.2017. Presidenti i Republikës e ka publikuar këtë fakt në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmjet shkresës nr.688/1 prot., datë 19.03.2018, ka njoftuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit Ilir Pashaj.

Subjekti, Z.Illir Pashaj e ka paraqitur këtë dorëheqje, me shkrim, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. KLD-ja me vendimin nr.18, datë 10.02.2017, ka deklaruar mbarimin e statusit për shkak dorëheqje të gjyqtarit Ilir Pashaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar mundësinë e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.
2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit".

Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3¹, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti dhe datës së botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.09.2016, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin² dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim³, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë deri në datën 25.10.2016. Në datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.01.2017. Si rezultat, afati 3-mujor, parashikuar nga neni 56, ka përfunduar në datën 31 mars 2017.

Paraqitja e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit brenda këtij afati, sjell si pasojë pushimin e procedurës së rivlerësimit, duke i dhënë këtij subjekti të drejtat e parashikuara në pikën 2, të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016.

¹Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Ligji quhet i shpallur, në qoftë se Presidenti i Republikës nuk ushtron të drejtat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe në paragrafin 1, të nenit 85. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.

²Pas miratimit nga Parlamenti në datën 22 korrik 2016, dhe kalimit të afatit 20-ditor, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016, mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vendosi pezullimin e zbatimit ligjit nr.84/2016 dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e tij me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ Në datën 18.01.2017, me vendimin nr.2, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 56 dhe 57, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për z.Illir Pashaj, Gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është pushuar.

Ky vendim u njoftohet Z. Ilir Pashaj, Komisionerëve Publikë dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të tij dhe duhet të depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

ROLAND ILIA

Kryesues



XHENSILA PINE

Relator

Ky vendim shpallet në datën 23.03.2018.

GENTA Tafa (BUNGO)

Anëtar